

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Winter 12-2017

ROLI I FINANCAVE PUBLIKE NË ZGJEDHJET ELEKTORALE NË PERIUDHËN E PAS LUFTËS NË KOSOVË

Gresa Konjufca

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Political Science Commons](#)



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

**ROLI I FINANCAVE PUBLIKE NË ZGJEDHJET ELEKTORALE NË
PERIUDHËN E PAS LUFTËS NË KOSOVË**
Shkalla Bachelor

Gresa Konjufca

Dhjetor / 2017
Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

Punim Diplome
Viti akademik 2014-2017

Gresa Konjufca
**ROLI I FINANCAVE PUBLIKE NË ZGJEDHJET ELEKTORALE NË
PERIUDHËN E PAS LUFTËS NË KOSOVË**

Mentor: Ruzhdi Matoshi

Dhjetor/ 2017

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Ky punim do të tentojë të identifikojë zgjedhjet të cilat janë mekanizëm i zakonshëm me të cilën demokracia moderne përfaqësuese vepron por e cila ka një kosto, kosto kjo që duhet të mbulohet nga financat shtetërore-publike. Këto janë mekanizmi me anë të cilit matet demokracia në një vend.

Për të parë se sa është një vend demokratik atëherë duhet të parë se sa është respektuar sistemi zgjedhor në atë shtet, sa kanë qenë demokratike zgjedhjet.

Ne në pika të shkurta do të mundohemi të flasim për gjeopolitikën elektorale të pasluftës në Kosovë. Ato janë mjet për mbushjen e një zyre apo marrjen e një posti përmes zgjedhjeve bërë nga një trup i caktuar njerëzish.

Në secilin vend modern, pavarësisht prej formës së tij të qeverisjes vendimet më të rëndësishme i marrin një grup i caktuar i njerëzve. Ne do ta përshkruajmë gjeopolitikën elektorale për këtë fakt, të shohim nëse përfaqësimi nga ai grup i njerëzve është në interes të një rajoni të caktuar apo në interes të tërë shoqërisë si tërësi.

Do t'i shtjellojmë të gjitha zgjedhjet e pasluftës të bëra në Kosovë, do të flasim për ligjet që kanë të bëjnë për zgjedhjet dhe formën e organizimit të tyre.

Nëpërmjet zgjedhjeve shtetasit ndërtojnë një ndër të drejtat e tyre themelore politike, të drejtën e zgjedhjes dhe të drejtën për tu zgjedhur. Me anë të zgjedhjeve ata ushtrojnë një ndër funksionet themelore, marrin pjesë drejtpërdrejt në ushtrimin e pushtetit, përkatësisht në ndërtimin e institucioneve shtetërore.

Pikërisht këto jemi munduar t'i paraqesim në punimin e bërë për zgjedhjet në Kosovën Pasluftës.

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Nuk mund të përshkruhen të gjitha ato çfarë kanë ndodhur që kur fillova studimet Bachelor në Kolegjin “UBT”. Me pak fjalë do mundohem ta përkufizoj vetëm falënderimin e disa prej shumë personave, të cilët më ndihmuan në përmbushjen e studimeve të mia, të cilëve do të doja t’u shpreh mirënjohjen time.

Një falendërim special shkon për Mentorin tim, prof. Ruzhdi Matoshi, për ndihmën dhe mbështetjen e qmuar që më ofroi përgjatë gjithë punës sime dhe kontributin e tij në finalizimin e punimit tim të diplomës, produk i shumë orëve konsultimi, këshillimi dhe mbështetje nga ana e tij.

Falendëroj miqtë e mi për mbështetjen që më kanë dhënë në çdo qast.

Dëshiroj, në fund, të shpreh një mirënjohje të thellë për familjen time së cilës i detyrohem shumë për fillimin dhe finalizimin me sukses të këtij rrugëtimi, sa të vështirë aq edhe të bukur.

Faleminderit të gjithëve!

Dhjetor, 2017

Prishtinë

PËRMBAJTJA

FJALORI I TERMAVE.....	V
1 HYRJE.....	1
2 SHQYRTIMI I LITERATURËS	3
2.1 Kuptimi dhe rëndësia e financave në gjeopolitikën Kosovare.....	3
2.2 Funksionet bazike të Financave publike	4
2.3 Buxheti dhe funksionet e tij si pjesë e financave publike.....	5
2.4 Mbështetja financiare e organit të zgjedhjeve elektorale (KQZ).....	7
2.5 Gjeografia Politike dhe ajo Elektorale (Rasti i Kosovës)	8
2.5.1 Objekti i Gjeografisë Politike dhe Etapat e Zhvillimit të saj.....	8
2.5.2 Funksionet e Zgjedhjeve.....	9
2.5.3 Rekrutimi i Politikanëve	9
2.5.4 Krijimi i Qeverive.....	10
2.5.5 Dhënia e Përfaqësimit.....	10
2.5.6 Ndikimi i Politikës.....	10
2.5.7 Edukimi i Votuesve	11
2.5.8 Ndërtimi i Legjitimitetit.....	11
2.5.9 Forcimi i Elitave	11
2.5.10 Parimet e së drejtës zgjedhore demokratike	12
2.6 Tranzicioni dhe Seria e Zgjedhjeve Parlamentare në Kosovë pas Luftës.....	13
2.6.1 Gjeografia e Zgjedhjeve Parlamentare e vitit 2001	14
2.6.2 Gjeografia e Zgjedhjeve Parlamentare e vitit 2004	16
2.6.3 Gjeografia e Zgjedhjeve Parlamentare e vitit 2007	17
2.6.4 Gjeografia e Zgjedhjeve Parlamentare e vitit 2010	18
2.6.5 Përcaktimi i Zonës/Zonave Elektorale në Zgjedhjet Parlamentare	19
2.6.6 Mbi madhësinë e zonave elektorale.....	19
Zgjedhjet e 31 Marsit 1991 -	19
Zgjedhjet e 22 Marsit 1992-	20

Zgjedhjet e 26 Majit të vitit 1996	20
Zgjedhjet Parlamentare të Qershorit 1997-	20
Zgjedhjet Parlamentare të Qershorit 2001	20
Zgjedhjet Parlamentare të Korrikut 2005	20
2.6.7 Veçori të Zgjedhjeve Parlamentare në Kosovë	21
2.6.8 Për sistemet Zgjedhore (Një Vështrim Hartografik)	22
3 DEKLARIMI I PROBLEMIT	26
4 METODOLOGJIA.....	27
4.1 Objektivi i studimit	27
4.2 Qëllimi i studimit	27
5 KONKLUZA DHE REKOMANDIME	28
6 REFERENCAT.....	29

FJALORI I TERMAVE

SDR -Sistemi Dyraundësh

IPLMP-(I pari listës merrë postin)

OSBE-ja (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian)

VVPT - Vota e Vetme e Patransferueshme

KQZ – Komisioni qendror i zgjedhjeve

PDK- Partia Demokratike e Kosoves

LDK- Lidhja Demokratike e Kosoves

AAK- Aleanca për ardhmërin e Kosovës

LDD- Lidhja demokratike e Dardanisë

AKR- Aleanca Kosova e re

OECD- Organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim

USAID- Agjensia e Shtetëve të Bashkuar për zhvillim ndërkombëtar

1 HYRJE

Financat publike janë një ndër shkencat më të vjetra ekonomike, gjë që ka qenë object shqyrtimi i ekonomistëve klasik si dhe i studiuesve të shkencave financiare në vazhdimësi deri në ditët e sotme.

Sot është e pamundur ekzistimi dhe funksionimi i ekonomisë kombëtare pa sektorin publik, i cili sektor përfshinë pothuajse një të tretën e ekonomisë kombëtare

Por sot fjala financë përherë është ngushtë e lidhur me çështjen shfrytëzimit të parave, të raporteve monetare ose me transaksionet (pagesat) me para.

Financa publike, paraqet aktivitetin shtetëror në lidhje me mbledhjen e të hyrave (të ardhurave) publike dhe realizimin e shpenzimeve (të dalave) publike

Gjeopolitika është një mënyrë e shikimit të botës: ajo merr parasysh lidhjen mes politikave dhe vendeve, mes gjeografisë, fuqisë dhe diversiteteve kulturore. Qoftë në rajonet e botës të përfshira nga luftërat, atje ku kufijtë bëhen çështje e jetës apo vdekjes, qoftë në SHBA apo Evropë, gjeopolitika është një pjesë e rëndësishme e jetës së përditshme globale. Madhësia e një vendi, lokacioni, sovraniteti, dhe resurset , të gjitha këto kanë ndikim tek njerëzit që jetojnë dhe kanë ndërveprime me botën e gjerë.(Komoni,S. 2008)

Gjeopolitika po ashtu paraqet situatë apo ngjarje të ndryshme duke përdorur përshkrime gjeografike, metafora dhe shprehje sikurse p.sh. “Perdja e Hekurt”, “Bota e tretë” , “Boshti i së keqes”etj. Këto shprehje përdoren që të tërheqin vëmendje sepse kanë tendencë të thjeshtësimit të politikave botërore dhe të identifikojnë miqtë dhe armiqtë potencial. Por edhe me qëllim të shpjegimit të ndonjë dukurie apo problemi, si në këto raste më lart, ose në të kundërtën, në raste tjera.

Katër traditat gjeopolitike britanike p.sh. ishin: Anglia e vogël/Britania, Britania Kozmopolitane, Britania Evropiane dhe Britania Amerikane. Kryeministri Britanik, z. Winston Churchill, në vitin 1946, p.sh. pat deklaruar se “Nga Stettini në Detin Baltik deri tek deti Adriatik, një perde e hekurt ka mbuluar Evropën”, duke iu referuar influencës të atëhershme sovjetike në atë kohe dhe njëkohsisht duke e kundërshtuar atë në mënyrë metaforike.

Filmat e krijuar me heroin britanik, James Bond, si p.sh. “Die another Day” paraqesin përpjekjet e agjentit britanik Bond, së bashku me kolegët amerikanë, që punonin për të ndaluar një kolonel të “çmendur” nga Koreja Veriore për të shkatërruar Korenë Jugore dhe Japoninë me një satelit të fuqishëm, dhe ky film në një mënyrë përputhej me përshkrimin e atëhershëm të presidentit amerikan Bush, për Korenë Veriore, “si një bosht i së keqes” dhe shfaqte qartë elemente të gjeopolitikës perëndimore në aspektin informativ, afirmativ por edhe propagandues. (Breznica,B. 2010)

2 SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Kuptimi dhe rëndësia e financave në gjeopolitikën Kosovare

Financat publike janë një ndër shkencat më të vjetra ekonomike, gjë që ka qenë object shqyrtimi i ekonomistëve klasik si dhe i studiuesve të shkencave financiare në vazhdimësi deri në ditët e sotme.

Sot është e pamundur ekzistimi dhe funksionimi i ekonomisë kombëtare pa sektorin publik, i cili sektor përfshinë pothuajse një të tretën e ekonomisë kombëtare

Por sot fjala financë përherë është ngushtë e lidhur me çështjen shfrytëzimit të parave, të raporteve monetare ose me transaksionet (pagesat) me para. (Komoni,S. 2008)

Financa publike, paraqet aktivitetin shtetëror në lidhje me mbledhjen e të hyrave (të ardhurave) publike dhe realizimin e shpenzimeve (të dalave) publike. Dy karakteristikat kryesore të dalave publike janë: a) ato shërbejnë për plotësimin e nevojave shoqërore, dhe b) dhe janë dalje në para. Pra të dalat publike janë dalat publike janë shpenzime në para të cilat i bën shteti dhe subjektet e tjera publike për plotësimin e nevojave të shoqërisë dhe për interesa publike. Më shumë duhet studiuar të dala publike sesa të hyrat publike, sepse më pare duhet caktuar të dalat publike me të cilat do të financohen nevojat publike (shoqërore) e pastaj duhet caktuar të hyrat publike si burim financiar i të dalave publike.

(Komoni,S. 2008)

Duhet cekur se me anë të dalave publike plotësohen këto nevoja publike (shoqërore):

- a) Nevojat e përgjithshme shoqërore (nevojat e administratës shtetore, mbajtja e ambasadave në botën e jashtme, dhënia e subvencioneve, financimi i armates etj).
- b) Nevojat e përbashkëta (nevojat e arsimit, cultures, shkencës, shëndetësisë, pensional dhe invalidor etj).
- c) Nevojat e natyrës ekonomike të shtetit (intervenimi i shtetit në ekonomi, investimi në infrastruktur, intervenimi në mardhëniet ekonomike ndërkombëtare etj).

Shteti me sovranitetin e vet financiar në formë urdhëruese ka për detyrë që t'i plotësoj nevojat publike siç janë: sigurimi i rendit public (policia), mbrojtja ushtarake e shtetit (armata), vendosja e rendit juridik. (Komoni,S. 2008)

Pastaj shteti i plotëson edhe nevojat tjera publike të përgjithshme- rregullimi i infrastruktures siç janë: rrugët, ndriçimi publik uji i pijshëm, mbrojtja e ambientit siguron mjetet për zgjedhjet elektorale etj.

2.2 Funkzionet bazike të Financave publike

Funksionet bazike të financave publike ndahen në tri lloje:

- a) Funkzioni alokativ
- b) Funkzioni i rishpërndarjes (ridistribuímit)
- c) Funkzioni stabilizues

Funksioni alokativ i financave publike ka për detyrë që t'i drejtojë apo ti shpërndaj mjetet në shtet apo në shoqëri në pjesën që shërben për plotësimin e nevojave publike respektivisht për financimin e ofertës së të mirave publike dhe në pjesë tjetër që i siguron mjetet për ofertën e të mirave private.

Andaj edhe në vet kuadrin e sektorin publik bëhet alokimi i mjeteve.

Funksioni alokativ i financave publike nuk ka të bëjë vetëm me sektorin publik ose në ndarjen e resurseve në mes të sektorit publik dhe atij privat.

Por ka të bëjë me ndikimin e sektorit publik përmes të hyrave dhe shpenzimeve publike në ecuritë dhe sjelljen e subjekteve ekonomike në sektorin privat dhe në atë në tërë ekonominë nacionale. (Komoni,S. 2008)

Funksioni i rishpërndarjes (ridistribuímit) ka të bëjë me rishpërndarjen e të ardhurave ndërmjet të:

- Individit dhe shtetit
- Sektorëve dhe
- Regjioneve.

Ndonëse ndarja e të ardhurave që realizohet me anë të tregut mund të jetë e arsyshme dhe e drejtë, prapëseprapë nuk mund të plotësohen kërkesat sociale dhe politike në shtet.

Kështu që raportet në shpërndarjen e të ardhurave për t'u realizuar në suaza optimal shoqërore, përveç tjerash mund të realizohen me masat e politikës fiskale.

Funksioni stabilizues është atëherë kur ekonomia nacionale del nga ekuilibri dhe është e nevojshme intervenimi i shtetit me masat e politikës ekonomike dhe në këtë drejtim edhe me masat në politikën e të hyrave dhe të shpenzimeve publike, të pengohet ose të vendoset përsëri ekuilibri d.m.th. të vendoset stabiliteti në treg i çmimeve, inkuadrimi i plotë i resurseve njerëzore dhe material, ekuilibër në bilancin e pagesave, shkalla e caktuar e ngritjes ekonomike dhe e ndryshimeve strukturale. (Komoni,S. 2008, fq 16-18)

2.3 Buxheti dhe funksionet e tij si pjesë e financave publike

Dihet mirëfilli për rolin dhe rëndësinë që ka buxheti i shtetit në aktivitetet shtetërore, zhvillimin e proceseve ekonomike, të çështjeve sociale e shumë çështje të tjera ekonomike, politike dhe juridike, si document ekonomiko-financiar i qeverisë kryen funksione të shumta dhe shumë të rëndësishme. (Kushtetuta, 2008)

Funksionet kryesore të buxhetit

- 1.funksioni ekonomik,
- 2.funksioni politik dhe
- 3.funksioni juridik.

1.Funksioni ekonomik- i buxhetit ka të bëjë me caktimin saktë të shpenzimeve publike si dhe të burimeve të mjeteve publike (të hyrave publike) me të cilat do të mbulohen shpenzimet publike.

Buxheti ka ndikim ekonomiko-financiar në

- a)stabilizimin ekonomik,
- b)rishpërndarjen e të ardhurave kombëtare dhe
- c)shpërndarjen (vendosjen) e resurseve në ekonomi.

Rrjedhimisht mund të themi se në kohën bashkëkohore buxheti, në rend të parë është instrument ekonomik nëpërmjet të cilit mund të intervenohet në zhvillimin ekonomik,në politikën sociale, si në politikën monetare, të tregut, ashtu edhe në segmente të tjera vitale të vendit në përgjithësi.

Ndikimi i buxhetit në politikën monetare është i rëndësishëm sepse me krijimin e suficitit buxhetor dhe pagimin e kreditit bankës qendrore, bëhet ndikimi deflacionist.

Ndërsa, financimi i deficitit buxhetor prej emisionit të parasë ka ndikim të madh inflacionist se shkakton joekuilibër në masën monetare apo sasinë e parave në qarkullim.

Në ekonomi, përveç ndikimit të buxhetit në prodhim, konsum, investime, çmime, në masën monetare etj, reflektojmë edhe politika fiskale. Funkzioni ekonomik është se përmes buxhetit bëhet rishpërndarja e të ardhurave, nëpërmjet të cilit shteti mund të ndikojë në investime të ndryshme në rritjen e ekonomisë, ku reflektimi i këtij procesi është sidomos kur ekonomia bie në recesion.

2. Funkzioni politik i buxhetit- me zhvillimin e buxhetit si instrument financiar, të cilin me procedurë të veçantë e aprovon organi përfaqësues, është shprehur e drejta buxhetore. Organi përfaqësues i bashkësisë shoqërore-politike e aprovon buxhetin për çdo vit, sepse pa lejimin e buxhetit nuk mund të kryhen funksionet e caktuara publike. Kjo paraqet funksionin politik të buxhetit. Nga aspekti politik duhet shqyrtuar:

- Iniciativën e propozimit të buxhetit,
- Metodën e nxjerrjes dhe aprovimit të buxhetit,
- Kontrollimin e buxhetit,
- Realizimin e buxhetit etj.

Prandaj ky funksion procedural paraqet funksionin politik të buxhetit. Nga aspekti politik, buxhetin duhet shqyrtuar përveç për procesin e aprovimit edhe atë të kontrollimit, menaxhimit dhe të realizimit të tij. (Kushtetuta, 2008)

3.Funksioni juridik i buxhetit- ka të bëjë me të drejtën financiare respektivisht me të drejtën buxhetore të shtetit.

Nëpërmjet buxhetit krijohen marrëdhënie të shumta në mes të organeve juridike publike (organeve dhe të administratës shtetërore), në një anë, dhe të personave fizikë dhe juridikë, në anën tjetër.

Prandaj, është me se e nevojshme që këto marrëdhënie të rregullohen me norma juridike përkatëse, janë të njohura me emrin e drejta buxhetore. (Kushtetuta, 2008)

2.4 Mbështetja financiare e organit të zgjedhjeve elektorale (KQZ)

Meqenëse temë diskutimi i punimit të diplomes janë zgjedhjet elektorale, ne do të përmendim shkurtimisht Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). KQZ është themeluar në pajtim me nenin 139 të Kushtetutës së Kosovës, dhe është një organ i përhershëm i pavarur i cili është përgjegjës për organizimin dhe implementimin e zgjedhjeve në Kosovë. Roli i KQZ-së është të rregullojë procesin electoral përmes miratimit të Rregullave Zgjedhore dhe, mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në të gjitha aspektet për të siguruar që zgjedhjet të arrijnë standardet ndërkombëtare.

KQZ-ja do t'ua adresojë të gjitha çështjet e personelit, buxhetit, prokurimit dhe çështjet procedural që kanë të bëjnë me operacionet e zgjedhjeve, këshillave gjegjës për veprim adekuat nga ana e tyre. Më në detaje lidhur mbi zgjedhjet, organizimin, sistemin, zonat zgjedhore e të tjera do të flasim në kapitujt në vijim. (KQZ,2015)

2.5 Gjeografia Politike dhe ajo Elektorale (Rasti i Kosovës)

Gjeografia është një lëndë shumë e rëndësishme sepse tregon tërësinë territoriale dhe studion gjeografinë e një vendi dhe të botës. Ka shumë zbulime të rëndësishme gjeografike p.sh: zbulimi i Amerikës, Australisë, Antarkut etj. Zbulime gjeografike mund të quajmë edhe zbulimet natyrore të një vendi.

Gjeografia politike është ngushtë e lidhur me gjeopolitikën. Ajo është degë e gjeopolitikës. Për të pasur një pasqyrë më të qartë për gjeografinë politike është me rëndësi të madhe të japim kuptimin e drejtë të gjeopolitikës. Në studimet e viteve të fundit gjeopolitika shihet si "pjesë e gjeografisë politike dhe studimi i marrëdhënieve ndërmjet gjeografisë, politikës dhe pushtetit dhe gjithashtu bashkëveprimit që lind nga kombinimi i tyre me njëri-tjetrin". Ka përkufizime të ndryshme për gjeopolitikën por shumica e autorëve pajtohen për disa prej elementeve të cilat do t'i përmendim në këtë pjesë.

Përkufizimi i gjeopolitikës përfshin:

1. një studim i ndikimit të faktorëve të tillë si gjeografi, ekonomi, dhe demografi në politikë dhe sidomos në politikën e jashtme të një shteti;
2. një politikë qeveritare të udhëhequr nga gjeopolitika;
3. një kombinim i faktorëve politikë dhe gjeografike në lidhje me diçka (si një shtet apo burime të veçanta). (Salihu,K 2004)

2.5.1 Objekti i Gjeografisë Politike dhe Etapat e Zhvillimit të saj

Ka përkufizime të shumta për gjeografinë politike të dhëna nga autorë të ndryshëm por ne do t'i përmendim disa më interesante të dhëna nga autorë të ndryshëm por të cilët nuk janë larguar shumë prej elementeve kryesore. "Gjeografia politike është degë e gjeografisë njerëzore, trajton një aspekt të veçantë të marrëdhënieve ambient-njeri me një theks të veçantë marrëdhëniet ndërmjet faktorëve gjeografikë dhe njësive politike" të bërë nga autori Wigert. Kurse sipas autorëve Karperson dhe Minghi "Gjeografia politike merret me studimin e strukturave tokësore dhe hapësinore dhe bashkëveprimi ndërmjet proceseve dhe sistemeve politike, ose thjesht, analiza hapësinore e fenomeneve politikë. Për të përshkruar nocionin e saktë të gjeografisë politike, duhet të bëjmë dallimin mes saj dhe gjeopolitikës.

(Yzeiri,E.2002). Gjeografia politike interesohet më shumë për shtrirjen hapësinore të dukurive politike,e të ndikimit të tyre mbi faktorët gjeografikë.

Për dallim prej saj gjeopolitika studion lidhjet e kundërta d.m.th. ndikimin e faktorëve gjeografikë,fizikë apo njerëzorë për analizat dhe zgjedhjet politike, të para këto lidhje me ato të subjekteve të tjera politike që veprojnë e ndikojnë mbi të njëjtin territor.

Gjeografia politike studion politikën e ndodhur dhe të realizuar, ndërsa gjeopolitika trajton dhe analizon politikën e ardhshme. Para se të flasim për gjeopolitikën elektorale të vendit tonë është me rëndësi që disa rreshta t'i kushtojmë edhe për funksionet e zgjedhjeve që janë me rëndësi të madhe për zhvillimin e demokracisë. Përveç funksioneve ne do të flasim për pak rreshta edhe për sistemet zgjedhore, të cilat janë me rëndësishme për të kuptuar atë sistem zgjedhor që është përdorur në vendin tonë dhe që dallon prej vendeve të tjera dhe prej sistemeve të tjera zgjedhore të aplikuara sot. (Yzeiri,E.2002)

2.5.2 Funksionet e Zgjedhjeve

Ndryshimet e viteve të 80-ta dhe 90-ta të cilat dërguan në shembjen e komunizmit ndikuan në demokratizimin e sistemit zgjedhor. Ku përfshihen e drejta e përgjithshme e votës, vota e fshehtë dhe konkurrenca zgjedhore. (Sartori,G.1998).

2.5.3 Rekrutimi i Politikanëve

Në shtetet demokratike, zgjedhjet janë burimi kryesor i rekrutimit politik, duke marrë parasysh gjithashtu proceset përmes të cilave partitë i emërojnë kandidatët. Politikanët kështu priren të zotërojnë dhunti dhe aftësi që lidhen me zgjedhshmërinë, si karizma, aftësitë oratorike dhe pamjet e mira, jo domosdoshmërisht ato që i përshtaten atyre për të kryer detyrat ndaj zonës së tyre, duke shërbyer në komitete, duke drejtuar departamente qeveritare e kështu me radhë. Zgjedhjet në mënyrë tipike nuk përdoren për të plotësuar poste që kërkojnë dije apo përvojë të veçantë, si ato në shërbimin civil apo gjyqësor. (Heywood,A 1997)

2.5.4 Krijimi i Qeverive

Zgjedhjet i përcaktojnë drejtpërdrejt qeveritë vetëm në shtete si ShBA, Franca dhe Venezuela, ku ekzekutivi politik zgjidhet drejtpërdrejt. Në sistemet më të zakonshme parlamentare, zgjedhjet ndikojnë formimin e qeverive më fort atëherë kur sistemi zgjedhor priret t'i japë një partie të vetme një shumicë të qartë parlamentare. Përdorimi i përfaqësimit proporcional mund të nënkuptojë se qeveritë formohen përmes marrëveshjeve pas-zgjedhore dhe që qeveritë mund të krijohen dhe të rrëzohen pa nevojën e zgjedhjeve. (Midgard,K/R,Erik,B. 2008).

2.5.5 Dhënia e Përfaqësimit

Kur janë të drejta e konkurruese, zgjedhjet janë mjet mes të cilit kërkesat kanalizohen nga publiku tek qeveria. Pa përdorë nismat e tërheqjen, elektorati s'ka mjete të dobishme të tjera për të siguruar që mandatet të zbatohen, manash aftësi e tij për të shkaktuar ndëshkim në zgjedhjet e ardhshme. Për më shumë, qeveritë e zgjedhura askund s'përbëjnë një mikrokozmos të shoqërisë më të gjerë.

2.5.6 Ndikimi i Politikës

Zgjedhjet sigurisht që i pengojnë qeveritë nga ndjekja e politikave radikale dhe thellësisht jopopullore, por vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur një çështje e vetme mbizotëron fushatën zgjedhore, mund të thuhet se ata e ndikojnë politikën drejtpërdrejt. Gjithashtu mund të shtjellohet se rangi i opsioneve të përvijuara në zgjedhje është në mënyrë tipike kaq i ngushtë sa që rezultatet mund të jenë vetëm me domethënie tepër të vogla politike. Të tjerë sugjerojnë se politika e qeverisë në të gjitha rastet formësohet nga diktate më praktike, si gjendja e ekonomisë, sesa nga gjykimet e saj zgjedhore. (Midgard,K/R,Erik,B. 2008).

2.5.7 Edukimi i Votuesve

Procesi i fushatës i jep elektoratit një bollëk informacioni lidhur me partitë, kandidatët, politikat, përvojën aktuale të qeverisë, sistemin politik me radhë. Gjithsesi, kjo pon në edukimin vetëm nëse informacioni që jepet, dhe mënyra në të cilën jepet ai, e përfshinë interesin e publikut dhe nxit debat, në dallim nga apatia dhe të-huajsimi. Ngaqë kandidatët dhe partitë kërkojnë të bindin e jo të edukojnë, ata gjithashtu kanë nxitës të fortë të paraqesin informacion të pasaktë dhe të shtrembëruar. (Midgard,K/R,Erik,B. 2008).

2.5.8 Ndërtimi i Legjitimitetit

Legjitimiteti nënkupton frymën autoritative apo detyruese, duke e transformuar kështu pushtetin në autoritet. Fjala legjitimitet rrjedh nga latinishtja legítimar, që nënkupton "shpalljen të ligjshme" gjerësisht nënkupton të qenit i duhur. Ai dallon nga ligjshmëria në atë se kjo e fundit nuk garanton domosdoshmërisht që një qeveri të respektohet apo që qytetarët e saj ta pranojë detyrimin e bindjes. Një arsye pse edhe regjimet autoritare e marrin mundimin të mbajnë zgjedhje, edhe nuk janë konkurrencte, është që zgjedhjet ndihmojnë nxitjen e legjitimitetit duke dhënë justifikim për një sistem sundimi. Kjo ndodhë sepse rituali i përfshirë në fushatë disi përçon mbi një zgjedhje një status ceremonial dhe një lloj rëndësie. Më e rëndësishmja, duke i nxitë qytetarët të marrin pjesë në politikë, edhe në formën e kufizuar të votimit, zgjedhjet sigurojnë pajtim të gjallë. (Heywood,A 1997)

2.5.9 Forcimi i Elitave

Zgjedhjet mund të jenë edhe një mjet përmes të cilit elitat mund të manipulojnë dhe kontrollojnë masat. Kjo mundësi e nxitit Proudhon-in të paralajmëronte se 'e drejta e përgjithshme për votë është kundërrevolucion'. Mospajtimi politik dhe opozita mund të neutralizohen nga zgjedhjet që i kanalizojnë ata në një kanal kushtetues dhe ia lejojnë qeverive të vijnë e të shkojnë ndërsa regjimi në vetvete mbijeton. Zgjedhjet janë veçanërisht të dobishme në këtë drejtim sepse, në të njëjtën kohë, ata i japin qytetarëve përshtypjen se po ushtrojnë pushtet mbi qeverinë. (Heywood,A 1997)

2.5.10 Parimet e së drejtës zgjedhore demokratike

Janë të njohur katër parime mbi të cilat mbështeten zgjedhjet demokratike në shumicën e vendeve e të cilat duhet të zbatohen pa kurrfarë kompromisi.

- Vota e përgjithshme
- Vota e barabartë
- Vota e fshehtë
- Vota e drejtpërdrejtë

Vota e përgjithshme- Kjo nënkupton të drejtën e përgjithshme për të marrë pjesë në zgjedhje, përkatësisht të drejtën e gjithë shtetasve që kanë mbushur moshën madhore, pa dallim race, besimi, gjinie, përkatësisht kombëtare, gjendje ekonomike, shkallë arsimit, kulturë etj.

Kjo nënkupton të drejtën që të zgjedhim (e drejta aktive) dhe të për tu zgjedhur ose (e drejta pasive).

Vota e barabartë- Vota e barabartë nënkuptonë që pasha e votës duhet të jetë e njëjtë.

Nuk duhet të ketë vota më shumë për disa persona familjarë, pastaj për më shumë për të arsimuarit.

Vota e fshehtë- Votimi i fshehtë është i kundërt me atë të hapur. Qëllimi është që të sigurohet liria e zgjedhjes e cila nënkupton që akti i votimit të jetë i lirë nga shtrëngimi ose presioni të palejshëm.

Votimi i drejtpërdrejt- Kjo nënkupton që vetë zgjedhësit, përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta përcaktojnë bartësit e mandateve. (Midgard,K/R,Erik,B. 2008).

2.6 Tranzicioni dhe Seria e Zgjedhjeve Parlamentare në Kosovë pas Luftës

Zgjedhjet për parlamentin e Kosovës dhe shtrija e partive në vendin tonë kanë ndryshuar dhe ndryshojnë shumë dhe atë për shumë arsye si:

- Partitë e tona ende nuk kanë programe të profilizuara;
- Ato nuk përkrahin një shtresë të caktuar të shoqërisë;
- Ato nuk janë të reformuara;

Kuvendi i Kosovës është i përbërë prej 120 vendeve prej të cilave 20 vende janë të rezervuara për komunitetet jo-shqiptare. Prej 20 vendeve të rezervuara 10 prej tyre shkojnë për komunitetin serb ndërsa 10 shkojnë për komunitetet tjera si (4 vende janë për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas, 3 janë për komunitetin boshnjak, 2 janë për komunitetin turk dhe një është për atë goran). Është e rëndësishme të theksohet se këto vende janë të rezervuara, çka i mundëson këtyre komuniteteve që edhe në bazë të zgjedhjeve të rregullta për 100 vendet të fitojnë edhe ndonjë deputet. (Lleshi, A. 2009)

Në Kosovë pas luftës janë mbajtur katër parë zgjedhje parlamentare dhe për secilën prej tyre do të flasim në vazhdim. (Lleshi, A. 2009)

1. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2001
2. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2004
3. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2007
4. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2010

2.6.1 Gjeografia e Zgjedhjeve Parlamentare e vitit 2001

Kosova ishte një vend i cili vetëm sa kishte dal nga një luftë e tmerrshme. Ajo nga shteti i ish-Jugosllavisë nuk kishte trashëguar një sistem zgjedhor të mirë. Gjatë okupimit ishin mbajtur zgjedhje në Kosovë por nuk ishin në nivelet çfarë duhej të ishin dhe atë për shumë arsye. Sistemi i zgjedhjeve në Kosovën e pasluftës ishte në kompetencë kryekëput të bashkësisë ndërkombëtare. Ata kishin për obligim të mbanin dhe monitoronin gjithë procesin zgjedhor. Ky sistem Kosovën e trajtonte si një njësi zgjedhore me shpërndarje proporcionale të vendeve përfaqësuese. Gjatë këtyre zgjedhjeve për llogaritjen e shëndërrimit të votave në vende përfaqësuese është përdorur formula Sainte-Lague. (Lleshi,A. 2009)

Në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të vitit 2001 kanë qenë këto elemente që i dallojnë ato zgjedhje si:

- Sistemi proporcional;
- Kosova një njësi zgjedhore;
- Lista e kandidatëve ka qenë me lista të mbyllura;
- Përfaqësimi gjinor (30 % të vendeve në Parlamentin e Kosovës kanë qenë të rezervuara për gjininë femërore); dhe
- Nuk ka pas prag elektoral.

Për monitorimin dhe udhëheqjen e zgjedhjeve ka qenë kompetente OSBE-ja (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian). Në ato zgjedhje kanë qenë rreth 1700 , 550 qendra të votimit dhe nga 750 votues në secilin vendvotim. Përfaqësimi gjeografik paraqet segment të rëndësishëm në zgjedhje, sikurse edhe në shumë fusha të tjera por në rastin e vendit tonë për të parë përfaqësimin e drejtë gjeografik duhet kohë dhe përmirësime në vetë sistemin zgjedhor dhe atë për shumë arsye:

1. Kosova është një njësi zgjedhore dhe ajo duhet të ketë më shumë njësi zgjedhore ose të ndryshojë sistemin e përfaqësimit në mazhoritar ose të kombunuar;
2. Kosova ende nuk ka regjistrim të plotë të popullsisë për afër 30 vite dhe nuk dihet shtirirja e saktë e popullsisë. (Lleshi,A. 2009)

Partitë politike fituan përkrahje në tërë komunat e Kosovës në sistemin e përfaqësimit proporcional me lista të mbyllura. Në këto zgjedhje nuk kishte prag elektoral.

Në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, të cilat u mbajtën më 17 nëntor të vitit 2001, numri i votuesve në këto zgjedhje, ishte 1.249.987 kurse pjesëmarrja në votime ishte 64%. Këto zgjedhje u bënë me lista të mbyllura, dhe u votua vetëm për subjektin politik. Subjektet politike, i caktuan kandidatët e tyre në listë dhe Kosova kishte një zonë elektorale.

(U zgjodhën 100 deputet, kurse 20 vende ishin të rezervuara. 1/3 e kandidatëve deputet, është përcaktuar në bazë të gjinisë. U votua në 1.668 vend votime dhe pati, 498 qendra votuese. (Kushtetuta,2008)

Korniza ligjore e cila ishte e vlefshme për zgjedhjet e para parlamentare për Parlamentin e Kosovës ishte:

- Korniza kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (2001/9);
- 12 Rregullore të miratuara nga KQZ-ja;
- 1 Rregullore e miratuar nga PSSP-ja.
- Udhëzimet e miratuara nga OSBE-ja.

Pjesëmarrëse ishin parti politike prej gjitha etniteteve që jetojnë në Kosovë. Prej tyre kemi: Shqiptar 19, Serbë 1, Romë 1, Boshnjakë 2, Turq 1, Ashkali 1, Egjiptian 1. (Kushtetuta,2008)

Rezultatet e zgjedhjeve të KQZ-së për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 për disa prej subjekteve më të rëndësishme pjesëmarrëse në ato zgjedhje: Lidhjen demokratike të Kosovës, Partinë Demokratike të Kosovës dhe Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës. Po i

përmendi këto. Përqindja e votuesve ishte më e përqendruar në këto parti LDK kishte 359.851 ose 45.65% me 47 mandate, PDK kishte 202,622 ose 25.70% me 26 mandate dhe AAK kishte 61.688 ose 7.83% me 8 mandate. (KQZ,2001)

E metë ishte për shembull Koalicioni "Kthimi" kishte 89.388 ose 11.34% me 22 mandate. Ajo kishte vetëm 28 mijë vota por kishte 22 mandate.

Për zgjedhjet e vitit 2001 ka pasur kritika të shumta si për formën e sistemit që është aplikuar ashtu edhe për parregullsitë të cilat u shfaqen. (Kushtetututa, 2008)

Ky sistem(*sistemi proporcional me lista të mbyllura*) kishte kritika dhe atë për shumë arsye:

1. Nuk kishte përfaqësim të drejtë të elektoratit;
2. Lista e mbyllura bënin që në atë mes të ketë kandidat të cilët zgjidheshin nga Partia;
3. Zgjedhja e kandidatëve bëhej nga padronët partiak të tyre dhe kishte mundësi më të madhe të kontrollit;
4. Të zgjedhurit nuk përfaqësonin elektoratin në tërë vendin, megjithëse ata zgjidheshin prej tërë votueseve.

2.6.2 Gjeografia e Zgjedhjeve Parlamentare e vitit 2004

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2004 në Kosovë është aplikuar sistemi proporcional me lista të mbyllura në të cilën vota shkonte për subjektin politik e jo për kandidatët. Në këto zgjedhje vjen në shprehje edhe një parti e re, e ajo ishte partia reformiste "ORA". Në zgjedhjet e vitit 2004 pjesëmarrja në votime ishte 52 % dhe për dallim prej vitit 2001, pjesëmarrja në votime u dobësua dukshëm. Në këto zgjedhje morën pjesë 33 (parti politike, iniciative qytetare dhe kandidat të pavarur).

Në zgjedhjet e vitit 2004 shihet rënie e votueseve të cilët ishin të zhgënjyer me klasën politike të atëhershme. Diçka për të cilën veçohen zgjedhjet e pasluftës edhe ato të vitit 2004 është shpërndarja gjeografike e votave.

Në Kosovë nuk ka dallim të madh të shpërndarjes së votave mes vendeve urbane dhe rurale, ndërsa ndryshe është çështja kur flasim për qytetet sepse atje ka dallime të

dukshme. Janë të njohura komunat bastione të disa subjekteve. (KQZ,2004)

Në zgjedhjet e vitit 2004 shumicën e qyteteve i fituan dy partitë kryesore të asaj kohe Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partisë Demokratike të Kosovës. Prej 30 komunave 21 prej tyre i takuan Lidhjes Demokratike të Kosovës, ndërsa 8 prej tyre Partisë Demokratike të Kosovës. Në bazë të rezultateve të asaj kohe shihej një rivalitet bipolar mes partive në Kosovë në njërën anë LDK-ja dhe në anën tjetër PDK-ja. (KQZ,2007)

2.6.3 Gjeografia e Zgjedhjeve Parlamentare e vitit 2007

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2007 në Kosovë ishte sistem i përfaqësimit proporcional me lista të hapura. Listat e deputeteve ishin të hapura dhe secili votues kishte të drejtë të një vote për subjektin përkatës dhe të votimit të dhjetë kandidatëve të listës partiake. Në këto zgjedhje për herë të parë është aplikuar pragu elektoral prej 5%.² Për dallim prej sistemit të mëhershëm në të cilën lista e kandidatëve ishin të hapura por vota shkonte për subjektin partiak ky sistem shihej më i favorshëm sepse, u mundësonte qytetarëve që të votojnë për personat e caktuar për të cilët mendonin se më lehtë i përfaqësonin interesat e tyre. (KQZ,2007)

Në pjesën e sipërme kemi paraqitur vetëm tri parti të cilat në zgjedhjet e vitit 2007 kanë qenë fituese të zgjedhjeve në komunat përkatëse. Partitë tjera kanë pasur shtrirjenëtërë Kosovën, por asnjëra prej tyre nuk ka arritur të fitojë ato. Ne do t'i paraqesim rezultatet e sakta për këto parti në secilin prej komunave të Kosovës.

Numri më i madhë i vendeve në Kuvend

- **PDK:** 37 deputet;
- **LDK:** 25 deputet ;
- **AKR:** 13 deputet;
- **LDD-:** 11 deputet;
- **AAK:** 10 deputet; (KQZ,2017)

2.6.4 Gjeografia e Zgjedhjeve Parlamentare e vitit 2010

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010 vjen në shprehje sistemi i përfaqësimit proporcional me lista të hapura, por për dallim me atë paraprak gjegjësisht atë të vitit 2007 në këto zgjedhje mundësia për të votuar për kandidat ishte deri në pesë sosh. Kosova njihet si një njësi zgjedhore. (KQZ,2010)

Këto zgjedhje erdhën si rezultat i rrëzimit të Qeverisë, gjegjësisht pas verdiktit të dhënë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës për shkeljet e kushtetutës nga ana e presidentit të Kosovës, i cili në atë rast mbante dy poste atë të Kryetarit të partisë dhe postin e Presidentit njëkohësisht për çka ishte në kundërshtim me kushtetutën.

Këto zgjedhje duhet të mbaheshin një vit më vonë. Kosova pas pavarësimit të saj në vitin 2008 po mbante për herë të parë zgjedhje të parakohshme. "Financial Times", "Independent" dhe "Guardian". Financial Times shkruante "Zgjedhjet e para në Kosovën e pavarur përfunduan me një garë të ngushtë mes dy partive në pushtet, që e shpallën shkëputjen nga Serbia.

Gazeta Britanike "Guardian" shkruan se zyrtarët e Bashkimit Evropian pohojnë se votimet janë shenjë e pjekurisë për shtetin e ri, i cili njihet nga 72 vende anëtare të OKB-së. E përditshmja "Independent" shkruan se të gjitha partitë e mëdha e mbështesin integrimin e Kosovës në NATO dhe në Bashkimin Evropian, vazhdimin e procesit të privatizimit dhe fillimin e bisedimeve me Serbinë. Gazeta shkruan se shqetësimi më i madh i votuesve kosovarë kanë qenë varfëria dhe papunësia e paprecedentë. Këto zgjedhje sollën parti dhe lëvizje tjera të reja të cilat erdhën në skenën politike të vendit tonë: Lëvizja Vetëvendosje, Partia FER.

Lëvizja Vetëvendosje arriti të hyjë në parlament kurse Partia FER nuk arriti që në herën e parë të jetë pjesë e parlamentit. Ndërsa në këto zgjedhje shihet ramja e madhe që pati partia e LDD-së e profesor akademik Nexhat Dacit. (KQZ,2010)

Zgjedhjet e vitit 2010 ishin, zgjedhjet e para nacionale të cilat ishin nën monitorimin e plotë nga ana e institucioneve vendase dhe ato si të tilla u përcjellën më probleme të natyrave të ndryshme si ato teknike dhe deri tek ato politike.

Fillimisht disa prej partive nuk njohën rezultatet preliminare, pastaj u bë përsëritja e tyre

në disa komuna në të cilat dyshohej për parregullsi dhe u rinumëruan rreth 40% të vendvotimeve. Pavarësisht këtyre Kosova tregoj pjekuri politike dhe ne kemi tani institucionet tona të cilat kanë dalë prej këtyre zgjedhjeve. (KQZ,2010)

Në zgjedhjet e vitit 2010 përqindja e komunave në të cilat fituan partitë ishte gati identike me atë të vitit 2007. Hiç Komunën e Suharekës ku fituese doli partia demokratike dhe hyrja e Vetëvendosjes si parti e re e cila doli e dyta në disa komuna tjetër risi nuk kishte. (KQZ)

2.6.5 Përcaktimi i Zonës/Zonave Elektorale në Zgjedhjet Parlamentare

Në zgjedhjet e pasluftës në Kosovë ka qenë si një zonë e vetme zgjedhore. Për këtë arsye në atë kohë sikurse edhe sot ka kritika të shumta se nuk ka pasur përfaqësim të drejtë. Kosova në zgjedhjet e parlamentare të pasluftës ka pas vetëm një zonë zgjedhore dhe me sistem proporcional të votimit. Ajo çka i cilëson zgjedhjet mes veti është se në dy zgjedhjet e para parlamentare ka pasur sistem proporcional me lista të mbyllura ndërsa në dy palë zgjedhjet tjera ka pasur sistem proporcional me lista të hapura. (Kushtetuta,2008)

Kosova ka vetëm një njësi zgjedhore dhe për këtë arsye ajo s'mund të jetë objekt trajtimi në këtë pjesë, por ne do të flasim për zonat elektorale të shtetit amë Shqipërisë, një model që ndoshta do të ishte i mirëseardhur edhe në vendin tonë, kur kihet parasysh edhe nevojën dhe domosdoshmërinë që të bëhen ndryshime në sistemin elektoral të tanishëm.

Në këtë pjesë në do të paraqesim modelin i cili u zbatua në vendin amë dhe i cili ka pasur ndarje të zonave elektorale nga 250 në vitin 1991 deri 12 zona në vitin 2009.

Këto si të tilla kanë prodhuar efektet e tyre sepse ka pasur një shpërndarje gjeografike më të madhe në tërë vendin dhe përfaqësim më të drejtë të deputetëve. Në vendin tonë po insistohet në ndryshime të Kodit Zgjedhor dhe kjo është një pjesë e debatit e cila do të na përcjellë në vitet e ardhshme, sidomos pas regjistrimit të popullsisë ku ne do të kemi një pasqyrë më të qartë për numrin e votuesve në tërë vendin. (Stavileci, A 2005)

2.6.6 Mbi madhësinë e zonave elektorale

Zgjedhjet e 31 Marsit 1991 - Në Zgjedhjet e para parlamentare në Shqipëri pas rrëzimit të sistemit monist të mbajtura me datë 31 Mars të vitit 1991 kishte 250 njësi zgjedhore ose zona elektorale. Sistemi i cili u aplikua ishte mazhoritar me balotazh (TRV-Two Round voting system), ose 50%+1. Për çdo zonë kishte nga 7850 votues potencial. Fitues në këto

zgjedhje ishte Partia e Punës me 169 vende në Parlament ose 67.6%, Partia Demokratike fitoi 75 vende ose 30%. (KQZ, 2017)

Zgjedhjet e 22 Marsit 1992- Në zgjedhjet e vitit 1992 kishte 100 zona elektorale. Kufijtë e zonave elektorale caktohen nga Presidenti i Republikës. Parlamenti do të kishte 140 deputetë. Sistemi i do të duhej të aplikohet ishte "mazhoritar i korrektuar" ndërsa në realitet ai i cili u aplikua ishte sistem i përzier me elemente proporcionale. Në këto zgjedhje fituese doli Partia Demokratike e cila fitoi 62.08% të votave ose 92 deputet, Partia Socialiste fitoi 25.74% ose 38 deputet etj. (KQZ, 2017)

Zgjedhjet e 26 Majit të vitit 1996- Këto zgjedhje nuk u mbajtën sepse ato zgjedhje u kontestuan dhe nuk ishin të lira dhe demokratike. Këto nuk zgjatën shumë sepse në Qershor 2007 u mbajtën zgjedhjet e reja. (KQZ, 2017)

Zgjedhjet Parlamentare të Qershorit 1997- Në këto zgjedhje i tërë vendi u nda në 115 zona elektorale. Duke a parë numrin e votuesve potencial në Shqipëri gjatë asaj kohe që ishte diku rreth 2 milion e 31 mijë, atëherë për çdo zonë duhej të ishin nga 17 mijë votues. Parlamenti kishte 155 deputet prej të cilëve 115 ishin nga votat e fituara në zgjedhjet një-emërore ndërsa 40 tjera i fitoni partitë nga votat e fituara nga përqindja e votave proporcionale në shkallë vendi. Partia Socialiste fitoi 53% të votave dhe morri 79 deputet ndërsa partia demokratike fitoi 25.16% dhe morri vetëm 27 vende.

Zgjedhjet Parlamentare të Qershorit 2001- Pavarësisht faktit se në zgjedhjet e vitit 2001 u munduan subjektet të ndryshonin ligjin elektoral ai ishte gati i njëjtë me atë të vitit 1992, gjegjësisht ai ishte proporcional i përzier. Sistemi i aplikuar ishte mazhoritar i korrektuar me dy raunde votimi. (KQZ, 2017)

Në këto zgjedhje fituese doli partia socialiste me 41.43% të votave dhe fitoi 73 mandate ndërsa partia demokratike e cila ishte në koalicion i njohur si koalicioni "Bashkimi për fitore" fitoi 36.88 dhe 46 mandate. (KQZ, 2017)

Zgjedhjet Parlamentare të Korrikut 2005 - Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen drejtpërdrejt nga zgjedhësit në zona zgjedhore një-emërore dhe 40 zgjidhen sipas përqindjes proporcionale të votave të fituara nga listat shumë-emërore të subjekteve zgjedhore të depozituara në KQZ.

Në këto zgjedhje fituese doli partia demokratike e cila fitoi 56 vende partia demokratike kurse partia socialiste fitoi 42 mandate.

Zgjedhjet parlamentare Qershorit 2009- Në zgjedhjet e vitit 2009 gjithashtu u parapa që Kuvendi i Shqipërisë ti ketë 140 deputet nga të cilët 100 zgjidhen drejtpërdrejt nga zgjedhësit në zonat zgjedhore një-emërore dhe 40 zgjidhen sipas përqindjes proporcionale të votave të fituara nga listat shumë-emërore të subjekteve zgjedhore të depozituara në KQZ. Në këto zgjedhje fituese doli "Koalicioni Aleanca e Ndryshimit" me 46.92 % ose 70 mandate, ndërsa "Koalicioni Bashkimi për Ndryshim fitoi 45.34 % ose 66 mandate. I tërë vendi ndahej në 12 zona elektorale. Madhësia e secilës zonë përcaktohej në bazë të numrit të votave. (KQZ, 2009)

2.6.7 Veçori të Zgjedhjeve Parlamentare në Kosovë

Në zgjedhjet parlamentare të pasluftës në Kosovë kemi disa raste specifike që i cilësojnë ato dhe për të cilat ne do t'i prekim në pjesën në vazhdim.

- Në të gjitha zgjedhjet e deritanishme parlamentare në Kosovë është aplikuar sistemi i përfaqësimit proporcional. Derisa në dy të parat kemi pasur sistem parlamentar me lista të mbyllura në dy të fundit ka qenë me lista të hapura.
- Zgjedhjet deri në vitin 2007 janë mbajtur në administrimin e faktorit ndërkombëtar, ndërsa pa kësaj ato fillojnë të administrohen nga faktori i brendshëm.
- Pjesëmarrja në votime ka pasur rënie të madhe derisa në zgjedhjet e para ka pasur përqindje prej 64 % në këto të fundit të mbajtura në vitin 2010 përqindja në votime ishte 45.29 %. (Kushtetuta,2008)
- Në zgjedhjet e vitit 2001 dhe 2004 kishte vetëm tri subjekte të cilat e dominuan skenën tonë politike kurse në zgjedhjet e vitit 2007 dhe 2010 në skenën tonë politike u shfaqën edhe parti të reja.
- Në zgjedhjet e vitit 2007, në vendin tonë për herë të parë u parapa edhe pragu elektoral për partitë të cilat dëshirojnë të jenë pjesë e parlamentit të vendit tonë. Ky prag ishte në përqindje prej 5% dhe pikërisht falë këtij pragu partia reformiste Ora mbeti jashtë parlamentit. Kjo ishte një goditje e madhe për partitë të cilat

kishin përquindje të vogël por të cilat arrinin të merrnin së paku një mandat.

2.6.8 Për sistemet Zgjedhore (Një Vështrim Hartografik)

Në këtë pjesë do të flasim për sistemet zgjedhore në përgjithësi, për llojet e tyre dhe do t'i cekim përparësitë dhe mangësitë e tyre. Gjithashtu do të paraqesim një vështrim hartografik të vendeve të Evropës lidhur me sistemet të cilat disponojnë. Këtë do ta paraqesim në një vështrim hartografik. (Heywood,A.1997)

1. Sistemi Mazhoritar
2. Sistemi i Përzier
3. Sistemi Proporcional

Sistemi mazhoritar

Janë disa variante të sistemit mazhoritar si:

- IPLMP(I pari listës merrë postin)
- Vota Blllok
- Vota Blllok Partiake
- Vota Alternative
- Sistemi Dyraundësh (SDR).

IPLMP-(I pari listës merrë postin)- Ky sistem është aplikuar në Britani të Madhe dhe vendet të cilat janë nën ndikimin e saj. Sipas sistemit i pari listës merrë postin kandidati fitues është thjeshtë ai që fiton më së shumti vota. Ne do të flasim për disa prej përparësive dhe mangësive të këtij sistemi. (Kushtetuta,2008)

Përparësitë:-

- a) Sistemi jep përzgjedhje të qartë në mes dy partive kryesore;
- b) Ky sistem krijon qeveri një partiake;
- c) Krijon një opozitë koherente parlamentare;
- d) U jep përparësi partive politike me bazë të gjerë;
- e) Përjashton nga përfaqësimi parlamentar partitë ekstremiste;
- f) Ruan lidhjen në mes elektoratit të një zone dhe deputetit të saj;

- g) Ky sistem u lejon zgjedhësve të bëjnë përzgjedhjen në mes të individëve e jo vetëm në mes të partive;
- h) Lejon mundësinë e zgjedhjes së kandidatëve të pavarur popullor;
- i) Sistemi IPLMP lëvdërohet posaçërisht ngase janë të thjeshta për t'u përdorur dhe për t'u kuptuar. (Kushtetuta,2008)

Mangësitë:

- a) Ky sistem përjshon partitë e vogla nga një përfaqësim i "ndershëm";
- b) Përjashtimi i minoriteteve nga përfaqësimi i ndershëm;
- c) Përjashtimi i grave nga parlamenti;
- d) Inkurajon zhvillimin e partive politike që bazohen në klanin, etnicitetin ose rajonin.
- e) Stërmadhon "çifligjet rajonale" ku një parti i fiton gjitha vendet në një krahinë/rreth.
- f) Le një numër të madh "votash të dështuara" që nuk kontribuojnë për zgjedhjen e ndonjë kandidati;
- g) Është i pandershëm ndaj ndryshimeve të opinionit publik;
- h) Sistemet IPLMP mund të jenë të ekspozuara ndaj manipulimit me kufijtë elektoral. (Kushtetuta,2008)

Sistemi Përzier

Sistemet e përziera janë ato sisteme që i shëndërrojnë votat e mbledhura në vende të fituara në një mënyrë të tillë që i bie diku në mes të proporcionalitetit dhe mazhoritetit. ((Heywood,A.1997)

Janë dy tipe kryesore:

- Vota e Vetme e Patransferueshme(VVPT);

- Sistemet Paralele

Sistemi i Përfaqësimit Proporcional

Ky lloj i sistemit zgjedhor është më dominant në vendet e Amerikës Latine dhe në Evropën Perëndimore. (Heywood,A.1997)

Avantazhet:-

- Përkthejnë në mënyrë besnike votat e mbledhura në vende të fituara duke shmangur kështu disa nga rezultatet më destabilizuese dhe të "padrejta" që dalin nga nga sistemet elektorale mazhoritare;
- Shkaktojnë një numër të vogël të votave të dështuara;
- Lehtëson përfaqësimin e partive më të vogla;
- I inkurajon partitë t'i ndërtojnë listat e kandidatëve të tyre sa më inkluzive dhe në aspektin shoqëror, me diversitet;
- Rrit mundësinë e zgjedhjes së përfaqësuesve të kulturave/grupeve minoritare;
- Rrit mundësinë e zgjedhjes së grave;
- E kufizon rritjen e "çifliqeve rajonale";
- Sjellin qeveri më efektive;
- E bën më transparente ndarjen e pushtetit në mes partive dhe grupeve të interesit.

Disavantazhet:-

- Qeveria të koalicionit të cilat pastja hyjnë në qorrsohak legjislativ e rrjedhimisht në paaftësi për të ndjekur politikë koherente në kohët e vështira, kur kjo gjë paraqitet më e nevojshme se kurrë;
- Fragmentim destabilizues të sistemitpartiak;
- Krijimin e një platforme për partitë ekstremiste;
- Koalicione qeveritare që nuk kanë terren të përbashkët-qoftë për sa i përket politikave

të tyre, qoftë për sa i përket mbështetjes së bazës;

- e) Paaftësi për të rrëzuar një parti nga pushteti;
- f) Dobësimin e lidhjes në mes të deputetëve dhe zonave të tyre elektorale;
- g) Përqendrimin e fuqisë në shtabet partiake;
- h) Për më tepër, përdorimi i sistemit PP presupozon një lloj structure të pranuar partiake, me që zgjedhësit kërkohet të votojnë për partite e jo për individët, apo për grupe individësh;
- i) Së fundi, sistemeve PP shpeshherë u duhet ta kapërcejnë një barrierë, sepse ato janë ende sisteme të panjohura për shumë vende me histori kolonializimi qoftë anglez apo francez.

Në Evropë më e theksuar është sistemi i përfaqësimit proporcional.

- 1) Sistemi Proporcional
- 2) Sistemi Mazhoritar
- 3) Sistemi i Përzier

3 DEKLARIMI I PROBLEMIT

Autorë dhe studiues të ndryshëm janë marrë me çështje që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike në Kosovë. Kosova synon të sigurojë një sistem të Menaxhimit të Financave Publike modern, në harmoni me standardet dhe përvojat më të mira ndërkombëtare. Kjo mundëson funksionimin efikas dhe efektiv të të gjitha fazave të menaxhimit të financave publike. Financat publike janë ndër shkencat më të vjetra ekonomike, që kanë qenë objekt shqyrtimi i ekonomistëve klasik si dhe i studiuesve të shkencave financiare në vazhdimësi deri në ditët e sotme. Qëllimi i strategjisë është që të arrihet një menaxhim i shëndoshë i financave publike duke i fuqizuar sistemet që sigurojnë ‘disiplinë fiskale’, ‘efikasitet funksional’, dhe ‘alokim efektiv’ të resurseve publike të Kosovës.

Refik Kryeziu është njëri nga studenti që ka bërë një hulumtim për financat publike që ka arritur në përfundim që ndërtimi dhe reformat të cilat janë bërë në sferën e financave publike duhet të jenë në funksion të harmonizimit me ligjet e aplikushme dhe reformimit të mëtutjeshëm të tyre, ndërsa për obliguesit tatimor dhe qytetarët në forma të ndryshme të jenë në funksion të shtimit më të madh të transparencës me qëllim të t’i kryejn obligimet e tyre dhe plotësimin e nevojave të tyre.

Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim(OECD) është një hulumtim që ka siguruar përkrahje financiare nga fondet e Instrumentit të Asistencës për Para-aderim(IPA) të Bashkimit Evropian(BE).

Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) ka qenë pjesë e një strategji për reformën e menaxhimit të financave publike të Kosovës që kushtëzohet me kërkesën që Kosova të ketë të miratuar një strategji të cilësisë së mire në fushën e menaxhimit të financave publike, me përkushtimin që fushat ku tashmë janë të rregulluara me standardet ndërkombëtare të vazhdojnë të mirëmbahen dhe përditësohen sipas zhvillimeve të kohës.

4 METODOLOGJIA

Ky punim përfshin zgjedhjet të cilat janë mekanizëm i zakonshëm ku mbulohen nga financat shtetërore-publike. Ky punim është përgatitur me anë të materialeve të ndryshme politike, Jam munduar të përdor teknika cilësore dhe jam përqëndruar edhe për gjeopolitikën elektorale të pasluftës në Kosovë. Si të dhëna primare janë përdorur librat websajtet. Studimi është në radhë të parë informues jo sipërfaqësor, që gjithësecili mund t'i kuptoj lehtësisht.

4.1 Objektivi i studimit

- Objekti i Gjeografisë politike dhe etapat e Zhvillimit të saj .
- Kuptimi dhe rëndësia e Financave Publike.
- Seria e Zgjedhjeve Parlamentare në Kosovë pas Luftës.

4.2 Qëllimi i studimit

Ky studim ka si qëllim të përcaktoj rëndësinë e Zgjedhjeve, ku në secilin vend modern, pavarësisht prej formës së tij të qeverisjes vendimet më të rëndësishme i marrin një grup i caktuar i njerëzve.

Studimi synon:

- Të kuptojme rolin dhe rëndësinë e financave publike.
- Edukimi i Votuesve.
- Dhënien e disa konkluzioneve dhe rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes.

5 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Zakonisht në çdo vend të botës buxheti respektivisht financat publike janë më të vogëla sesa kërkesat apo nevojat shtetërore. Në këtë mënyrë zgjedhja dhe prioritizimi i kërkesave të cilat kërkojnë mjete financiare publike nuk është aspak punë e lehtë duke përfshirë edhe zgjedhjet elektorale. Përcaktimi, organizimi dhe mbulimi i shpenzimeve të zgjedhjeve kërkon një shumë të caktuar buxhetore që në shumicën e rastëve nuk është e vogël dhe paraqet një sfidë për buxhetin edhe ashtu tejet të vogël të Kosovës. Zgjedhjet janë njëra prej sfidave me të cilat po ballafaqohen shumica e vendeve të tranzicionit. Nëpër këtë proces kanë kaluar shumë vende anembanë botës, e në mesin e atyre vendeve është edhe vendi ynë Kosova. Ato kritikohen shumë për shkak të manipulimeve me të cilat përcjellën, dhe për faktin se në vendet e tranzicionit zgjedhjet kanë qenë nën kontroll të aparatit udhëheqës, si dhe për arsye se zgjedhja e atyre personave ka sjellur beneficione për ta dhe familjet e tyre. Zgjedhjet janë e vetmja mundësi në të cilën votuesit mund të marrin pjesë në ushtrimin e pushtetit. Ato janë mekanizëm i rëndësishëm në secilin vend dhe me to matet shkalla e demokracisë që mbretëron në secilin shtet. Në fillim ato kontrolloheshin nga ana e bashkësisë ndërkombëtare dhe mundësia e manipulimit me to ishte e vështirë dhe rëndësia e atyre nuk ishte sa ato vlejné sot, sepse pjesa kryesore e institucioneve kontrolloheshin prej ndërkombëtarëve. Pas kalimit të kohës ato kaluan në duart e vendorëve dhe menjëherë u përcjellën me gabime dhe probleme. Kjo ishte e qartë duke pasur parasysh se Kosova është një vend i cili vetëm sa ka dal prej luftës dhe okupimit të saj. Qëllimi i këtij punimi është që të paraqes më shumë gjeopolitikën elektorale, gjegjësisht rëndësinë e faktorëve gjeografik të zgjedhjeve se sa një analizë të thuktë të tyre. Duke pasur parasysh se Kosova është një zonë zgjedhore, në këto raste ka pak rëndësi gjeografia përkatësisht zgjedhja e partisë e sidomos e kandidatit. Ne megjithatë kemi paraqitur në një pjesë modelin e Shqipërisë se si duket rasti kur kemi të bëjmë me shtet I cili disponon sistem me shumë zona zgjedhore. Nëse Kosova duhet ta ketë një model të tillë kjo do të jetë pjesë e debateve për të ardhmen.

6 REFERENCAT

Komoni, S. (2008). *Financat Publike*. Prishtinë.

Yzeiri, E. (2002). *Gjeografia Politike e Shqipërisë në Tranzicion*. Tiranë.

Salihu, K. (2004). *E Drejta Kushtetuese*. Prishtinë.

Heywood, A. (1997). *Politika*. Bakingstone.

Sartori, G. (1998). *Edhe një herë për teorinë e Demokracisë*. DITURIA.

Midgard, K/R. Erik, B. (2008). *Demokracia*. Prishtinë: ROZAFIA.

Stavileci, E. (2005). *Nocione dhe Parime të Administratës Publike*. Prishtinë.

Lleshi, A. (2009). *Gjeopolitika e Ballkanit dhe Perspektivat e Sigurisë në Rajon*.

Breznica, B. (2010) *Gjeopolitika si mënyrë për të shpjeguar disa nga politikat dhe interesat e shteteve të ndryshme*.

Kushtetuta e Kosovës. (2008). Qasshëm nga:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702> [Qasja: 28.10.2017]

Listat e zgjedhjeve parlamentare 2001-2008. [Qasja: 10.11.2017]

Qasshëm nga: <http://www.cec.org.al/sq-al/PE2005-Documentation/aid/867>

Listat e zgjedhjeve parlamentare 2001-2008. Qasshëm nga: <http://www.cec.org.al/sq-al/PE2005-Documentation/aid/867> [Qasja: 11.11.2017]

Zgjedhjet e pergjithshme në Kosovë. Qasshëm nga:

<http://www.kqz-ks.org/sq/zgjedhjet-e-pergjithshme> [Qasja: 15.11.2017]

Qasshëm nga: <http://kosovare.forumotion.com/t903p90-cka-permban-plani-i-atisarit-per-kosoven> (Pakoja e Ahtisarit) [Qasja: 16.11.2017]